



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:239582
Datë: 09.08.2023
Numri i dokumentit: 04570735

C-IV-14-2358

Ankuesi

Z S Sh

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Lakrishte , Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 07 gusht 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI042-4856, i datës 14 mars 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 04 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. GJI042-4856, të datës 14 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar që të kompensohet për pagat e papaguara, në shumën prej 21,600.00 €, për periudhën kohore nga 01 prill 1999 deri me 01 qershor 2011, nga NSH PMN “SHARR”(në likuidim).

Ankuesi pohoi se ka punuar në NSH, që nga 01 shkurt 1996 e deri më datën 15 qershor 1999, deri në momentin kur në Kosovë kanë hyrë forcat e KFOR-it dhe më nuk kemi mundur të udhëtojmë për në punë. Ankuesi gjithashtu pohon se ka punuar në ndërmarrje dhe ka qenë punëtor aktiv nga viti 1996-1999, andaj kërkon nga Dhoma e Posaçme, që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të marr vendim, që të aprovet ankesa dhe të obligohet AKP-ja, dhe të refuzohet vendimi i AL-së

Me 27 janar 2017, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje, në të cilën ka pohuar se AL-ja ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore janë aplikuar saktësisht. Po ashtu, e paditura pohoi se pretendimet e ankuesit janë të parashkruara, pasi që ankuesi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik kundër NSH-së gjatë periudhës 01 prill 1999 deri me 01 qershor 2011, andaj kërkesa u refuzua si e parashkruar, konform nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Me 01 shkurt 2017, mbrojtja e AKP i është dorëzuar ankuesit, i njëjti nuk parashtrroi përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar, kurse vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, GJI042-4856, i datës 14 mars 2014, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në pajtim me nenet 2.4 dhe 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore, dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Gjykata gjen se neni 608 i ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga

marrëdhënia e punës, megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për pagat e paguara të kërkuara në këtë lëndë (pagat për periudhën 01 prill 1999 – 01 qershor 2011) ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar të pagave të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës dhe pohimeve të vet ankuesit, i njëjti kërkesën e ka parashtruar lidhur me pagat e pa paguara për periudhën 01 prill 1999 – 01 qershor 2011, në shumë prej 21,600.00 €. Po ashtu, nga shkresat e lëndës rrjedh se ankuesi kërkesën për pagat e pa paguara e ka parashtruar pranë Autoritetit të Likuidimit më 06 qershor 2011, që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashtruar.

Ankuesi ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Kërkesa e ankuesit për pagat e pa paguara për periudhën 01 prill 1999 – 01 qershor 2011, është parashtruar brenda afatit 3 vjeçar, që i bie se afati i parashkrimit për pagën e fundit ka arritur më 01 korrik të vitit 2002, ankuesi kërkesën e ka parashtruar në muajin qershor të vitit 2011, që do të thotë jashtë çdo afati të paraparë ligjor. Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo

argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket parashkrimit të së drejtës për të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e pa paguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar. Po ashtu, ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar faktin se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore apo se ka parashtruar kërkesë për borxhin e pretenduar pranë organeve kompetente para ushtrimit të kërkesës pranë AL-së, kështu që do të kishim edhe ndërprerje të afatit të parashkrimit.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e parashtruar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare

C-IV-14-2358

Podnosilac žalbe

Z S,Š

Protiv

Tužena

Kosovska Agencija za Privatizaciju, (KAP) Ul. "Dritan Hoxha" br.55 Lakrište, Priština.

Posebna komora Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku Agenciju za Privatizaciju (Posebna komora), sudija Diellza Hoxha, je dana 07 avgusta 2023 godine, donela ovu:

P R E S U D U

- 1. Žalba se ODBIJA kao neosnovana**
- 2. POTVRĐUJE se Odluka Organa za likvidaciju, GJI042-4856 od 14 marta 2014 godine, kao pravična i zasnovana na zakonu.**
- 3. Žaliocu se ne određuje sudski troškovi.**

Çinjenične i proceduralne okolnosti

Žalioc je 14 aprila 2014 godine podneo žalbu Posebnoj Komori na Odluku br. GJI042-4856, od 14 marta 2014. godine, Organa za likvidaciju Kosovske Agencije za Privatizaciju (u daljem tekstu Organ za likvidaciju ili skraćeno OL), kojim je zahtevao da mu se nadoknadi za neisplaćene zarade iznos od 21,600.00 evra za period od 01 aprila 1999 do 01 juna 2011 godine od DP PMN "Sharr".(u likvidaciji)

Zalioc je tvrdio da je radio u DP-u od 1. februara 1996. do 15. juna 1999. godine, do trenutka kada su snage KFOR-a ušle na Kosovo i mi više nismo mogli da putujemo na posao. Podnosilac žalbe takođe tvrdi da je radio u preduzecu i da je bio aktivan radnik od 1996. do 1999. godine, stoga traži od Posebne komore, nakon uvida u dokumentaciju, da donese odluku, da usvoji žalbu i obaveže KAP, i da se rešenje OL odbije.

Dana 27 januar 2017 godine, tužena KAP je podnela odbranu, u kojoj je tvrdila da je OL izvršio tačnu procenu činjeničnih okolnosti i da su važeće zakonske odredbe pravilno primenjene. Tužena je takođe tvrdila da su navodi podnosioca žalbe zastareli, pošto podnosilac žalbe nije preduzeo nikakve pravne radnje protiv DP-a, u period od 01 aprila 1999 do 01 juna 2011 god. stoga je zahtev odbijen kao zastareo, shodno članu 608. Zakona o Udruženom Radu.

Pravno obrazloženje

Žalba se odbija kao neosnovana, a odluka Organa za likvidaciju se potvrđuje kao pravična i zasnovana na zakonu.

Na osnovu člana 2.4 i člana 77.1.1.1 Zakona br. 06-L-086 o Specijalnoj komori Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju (Zakon o Specijalnoj komori), sud će sprovesti proceduralne odredbe ovog zakona.

U skladu sa članom 76.3 Zakona o Posebnoj komori, u vezi sa članom 399. Zakona o parničnom postupku, Sud nalazi da činjenice sadržane u žalbi ne potkrepljuju je i donosi ovu presudu bez zakazivanja rasprave.

Sud je temeljno ispitao sav materijal koji su mu obe strane predočile i utvrdio da je jedno od materijalno spornih pitanja između stranaka zastare, što je kao takvo pitanje regulisano zakonskim odredbama i pošto sud utvrdi da je propisano pravo na traženje sudske revizije za ispunjenje obaveze, ostale tvrdnje stranaka neće se ispitivati.

Član 37.4.4.1 Aneksa Zakona KAP-a, predviđa:

“Potraživanja koja su zastarela prema periodu zastarevanja utvrđenom važećim zakonom i potraživanja koja nisu pravilno i blagovremeno predata sudu koji je nadležan u tom pogledu, odbacuju se i nemaju pravo da učestvuju u bilo kojoj raspodeli od likvidacije“.

Sud nalazi da je član 608. Zakona o Udruženom radu (Službeni list br. 53/76) kojim se zasniva odluka o odbijanju KAP-a je ukinut Zakonom o izmenama i dopunama Zakona o preduzećima (SL 40/89) koji je zakon stupio na snagu 15. jula 1989. godine, konkretnije članom 74, koji član dopunjava Zakon o preduzećima SL 77/88 (koji je stupio na snagu 1. januara 1989. godine), tačnije član 196, koji izričito predviđa ukidanje svih odredaba Zakona o udruženom radu, osim odredaba poglavlje IV i poglavlja VI odeljak 2, odredba člana 608. utvrđena je u poglavlje VI u poglavlju 3, što znači da je ukinuta ovom izmenom zakona. Zakon o radnim odnosima od 14. aprila 1989 i Zakon o osnovnim pravima o radnim odnosima od 28. septembra 1989. godine, oba ova zakona nisu predvidela posebne odredbe u vezi sa zastarevanjem novčanih potraživanja koja proizilaze iz radnog odnosa. Međutim, to ne znači da institut zastarevanja za novčana potraživanja ostao ne obuhvaćen zakonskim odredbama.

Sud procenjuje da bi trebalo da se primenjuje opšta zastarelost za civilne obaveze u vreme kada se smatra da je nastala obaveza. Ova pravila se nalaze u Zakonu o obligacionim odnosima (ZOO) br. 690 od 30. marta 1978. godine, ista pravila nalaze se u Zakonu br. 04/L-077 o obligacionim odnosima (ZOO) koji je stupio na snagu 19. decembra 2012. godine. U skladu sa članom 372, stav 1 ZOO, zastarevanje periodičnih zahteva kao što je plata je tri (3) godine; Novi zakon je zadržao isti zakonski rok zastarevanja od 3 godine (član 353. stav 1. ZOO-a). Takođe, Zakon o radu br. 03 / L-212, koji je na snazi, ne predviđa poseban statut zastarevanja na isplatu dohotka, već predviđa opšti rok od 3 godine zastarelog potraživanja u vezi sa zapošljavanjem. Iz gornjih odredaba Sud smatra da je zastarenje kao građanskopravni institut uopšte, a posebno trogodišnji rok zastarevanja, su sačuvano svim tadašnjim zakonima, ali i u zakonima koji su sada na snazi.

Dakle, može se videti da je rok zastarelosti neisplaćenih zarada potrebnih u ovom slučaju (plate za period od 01 aprila 1999 do 01 juna 2011), regulisan ZOO-a (1978), koji je tada još uvek bio na snazi. Tek se u decembru 2012. godine promenio važeći zakon, ali čak sadašnji važeći ZOO zadržao isti zakonski rok zastarevanja od 3 godine.

Zastarevanjem, zakonski prestaje pravo potraživanja ispunjavanja obaveze, zastarevanje počinje da teče prvog dana nakon što je poverilac imao pravo da potražuje ispunjavanje obaveze, izuzev ukoliko se zakonom, u posebnim slučajevima, ne predviđa nešto drugo. U konkretnom slučaju, pravo na potraživanje navodne naknade za neisplaćene zarade je zakonski zastarelo nakon 3 godine, nakon što DP nije ispunilo svoje obaveze prema podnosiocu potraživanja u roku i pošto žalioac nije priložio bilo kakav dokaz da je podneo potraživanje u bilo kom sudskom postupku ili pred bilo kojim nadležnim organom u roku od tri godine, da potražuje navodni dug u vezi sa neisplaćenim platama i na taj način spreči da rok zastarevanja teče. Prema spisima predmeta, žalioac je podneo potraživanje za neisplaćene

zarade, za period od 01 aprila 1999 do 01 juna 2011 god.u iznosu od 21,600.00 € . Iz spisa predmeta proizlazi da je žalioc, dana 06 juna 2011 godine, podneo potraživanje Organu za likvidaciju, ali da je takvo potraživanje, na osnovu gore navedenih zakonskih odredbi, u to vreme već zastarelo.

Žalioc je imao pravo da traži ispunjenje navodne obaveze nakon svakog prethodnog meseca za koji nije isplaćena zarada, pa je zastarelost nastupila za svaki mesec neisplaćenih zarada posebno. Zahtev zalioca za isplatu neisplaćenih zarada za period od 01 aprila 1999 do 01 juna 2011 zastareva u roku od 3 godine, koji zastareva za poslednju platu ostvarenu 01 jula 2022 godine, zalioc je podneo zahtev u junu 2011. godine, kojim znači van svakog zakonskog roka. Žalioc , podnošenjem žalbe na rešenje OL, nije naveo nijednu činjenicu ili pravni argument koji bi promenio činjenično stanje, u pogledu zastarelosti prava na sudsko potraživanje neisplaćenih zarada, a samim tim i zbog uticaja na promenu činjeničnog stanja. žalba na odluku.

Takođe, žalioc nije izneo nijedan dokaz kojim bi dokazao da je pokrenuo bilo kakav sudski postupak ili da je podneo zahtev za navodni dug nadležnim organima pre podnošenja zahteva OL, tako da bismo imali prekid rok zastarelosti.

Stoga je, na osnovu navedenog, au skladu sa članovima 54.1 i 74.4 Zakona o Posebnoj Komori, odlučeno kao u dispozitivu presude.

Sudski troškovi

U skladu sa članom 62.5 Zakona o Posebnoj komori, svaka stranka snosi svoje troškove. Žalioc je platio sudsku taksu .

Pravni savet

Protiv ove presude može se izjaviti pismena žalba Žalbenom veću Posebne komore u roku od 15 dana od prijema ove presude. Žalba se mora podneti na osnovu člana 9.6. Zakona o Posebnoj komori.

Diellza Hoxha
Sudija

Numri i lëndës: 2022:239582
Datë: 09.08.2023
Numri i dokumentit: 04570735